Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1000

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE "AS Tech Sh.P.K."- Prishtinë kundër Vendimit për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe riparimi i klimave dhe chilerave për nevoja të PK-së" me nr. të prokurimit: "vetak-23-11095-2-3-6" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Posta e Kosovës Sh.A., më 31/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e OE "AS Tech " Sh.P.K."- Prishtinëme nr. 2023/1000, e datës 11/12/2023, kurse vendimi i AK Posta e Kosovës Sh.A.lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe riparimi i klimave dhe chilerave per nevoja te PK-se" me nr. të prokurimit: "vetak-23-11095-2-3-6", mbetet në fuqi, anulimi i aktivitetit të prokurimit.

2. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.10.2023 Posta E Kosovës Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Servisimi dhe riparimi i klimave dhe chilerave për nevoja te PK-se" me nr. të prokurimit: "vetak-23-11095-2-3-6".

Ndërsa me datën 22.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 9,500.00 €.

Me 27.11.2023 OE “" AS Tech " Sh.P.K.”- Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 29.11.2023, Autoriteti Kontraktues ku ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE : " AS Tech " Sh.P.K.”- Prishtinë me nr. 1000/23 për lidhur me aktivitetin “Servisimi dhe riparimi i klimave dhe chilerave për nevoja te PK-se” me nr. të prokurimit: "vetak-23-11095-2-3-6".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesOE “ AS Tech " Sh.P.K.”*janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se : “Ankesën e parashtrojmë kundër Vendimit te AK-se te dates 22.11.2023 ku AK e Anulon aktivitetin ndërsa ofertën tone e konsideron te papërgjegjshme lidhur me projektin Servisimi dhe riparimi i klimave dhe chilerave për nevoja të PK-së me NR. vetak-23-11095-2-3-6 AK pretendon se ne kemi bere tejkalim te vlerës se parashikuar, kjo nuk qëndron sepse ne kemi vendosur çmime te arsyeshme sipas kërkesës për çmime për njësi tek paramasa. Kërkesë e AK ne paramase ka qene vendosja e çmimeve për njësi, ashtu edhe i kemi vendosur dhe nuk është askund e bazuar ne ligj qe oferta jone te këtë tejkaluar vlerën. Sipas ligjit çmimet vendosen për njësi për ta vlerësuar ofertën me te lire ndërsa ne implementim te kontratës, ndërpritet ekzekutimi i saj ne momentin qe arrihet vlera e parashikuar ne këtë rast prej 9,500 euro. Oferta jone është dhënë e poentuar dhe askund nuk kemi dhënë çmim 28,000 euro siç pretendoni. AK ka vendosur disa sasi ne dosje te tenderit por qe ato nuk kane qene detyrim nga ana jone qe ti plotësojmë, ne e kemi plotësuar paramasen ashtu siç është dhënë nga AK. Përfundimisht themi se AK ka shkelur nenin 7, 59, 60 por po ndalemi tek neni 62: Neni 62 -Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 2.Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve. AK anulimin e aktivitetit nuk e mbështetet ne asnjërin rast te cekur me larte, prandaj kjo ky Vendim është i pabaze. Oferta jone është e përgjegjshme ne çdo aspekt te dokumentacionit, madje edhe çmimet janë shume te

arsyeshme dhe AK askund nuk e mbështet vlerësimin e saj se kemi dhënë çmime te larta, AK ne asnjë rast nuk ka dhënë një sqarim se pse çmimet tona janë te larta, nuk ka bëra asnjë krahasim me çmimet e tregut aktualisht. Është e pavend krahasimi i çmimeve te ofertës tone ne këtë vit dhe ato te kontratave te kaluara kur dihet shume mire se çmimet janë rritur ne çdo aspekt sidomos 2 vitet e fundit. Nuk mund te merret si çmim referent një kontrate e para disa viteve dhe te krahasohet me çmimet aktuale te tregut. Ne jemi shume te vetëdijshëm për çmimet qe kemi dhënë, por AK e ka eliminuar ofertën tone pa kërkuar aspak sqarime. AK s'ka qene e interesuar për ta shpërblyer ofertën tone prandaj si ka ndjek hapat ligjor dhe shfrytëzimin e ligjit siç duhet. OE Nuk duhet te eliminohet një oferte për një kriter qe nuk është i vendosur ne dosje, ndërsa AK e eleminoni ofertën tone sepse sipas AK-se sasitë qe ka menduar për ti impelentuar janë te mëdha madje edhe e tejkalojnë vlerën te parashikuar. Ne kemi ofertuar sipas paramases dhe vlerës se parashikuar."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE : OE **"AS Tech " SH.P.K."** konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, 62 të LPP-së. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) aprovim te ankesës tone, kthim te lendes ne rivlerësim dhe shpërblim te ofertës tone me kontrate ".

Përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim : "Autoriteti Kontraktues sqaron se qëllimi i nenit 7 dhe 59 të LPP-së është që të udhëzoj autoritetet kontraktuese se si ti trajtojë të gjithë operatoret ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim, në mënyrë transparente si dhe konform kërkesave dhe dëshmive të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, po ashtu në këtë aktivitetet të prokurimit AK konform nenit 59 të LPP-së ka themeluar komisionin e vlerësimit dhe i njëjti ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit/ofertës duke respektuar dhe trajtuar ofertën, konform kërkesave të parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Komisioni i vlerësimit në përputhje me nenin 59 dhe 60 të LPP-së si dhe konform kërkesave te parashtruara në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit ka ardhur në përfundim se oferta e juaj është e përgjegjshme administrativisht, mirëpo pasi që ka bërë vlerësimin e ofertës dhe krahasimin e çmimeve në ofertën e juaj/OE "As Tech shpk" me çmimet e tregut të analizuara dhe përcaktuara nga njësia kërkuese me rastin e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit si dhe me çmimet e kontratave paraprake dhe duke pas parasysh sasinë e pajisjeve të paraqitura në aneksin 1 të dosjes së tenderit ka ardhur në përfundim se oferta e juaj respektivisht çmimet e ofertës tuaj janë çmime të cilat në mas substanciale janë më të larta se çmimet e tregut. Komisioni ka bere edhe kalkulimin e sasive të artikujve të parapare në aneksin 1 të dosjes së tenderit me çmimet për njësi të ofruar nga ana e juaj/OE As Tech dhe mbi bazën e kalkulimit, është nxjerr rezultati se nëse pranohet oferta e juaj/OE As Tech, dhe vetëm nëse nga njëherë bëhet servisimi i tyre/artikujve-paisjeve të parapara në dosje atëherë AK PK Sh. A do ti kushtoj respektivisht do të paguaj 28,380.00 €, ndërsa buxheti i planifikuar për këtë aktivitet nga AK është parashikuar në vlerë prej 9,500.00 €, me çka konstatohet se oferta e juaj e tejkalon në mas substanciale edhe buxhetin e planifikuar nga AK PK sh.a. Andaj, bazuar në paragrafin 2.1 të nenit 62 të LPP AK Posta e Kosovës sha ,përkatësisht drejtoria e prokurimit bazuar edhe në rekomandimin e komisionit të vlerësimit anulon aktivitetin e prokurimit. Në shqyrtim u vërtetua

se Autoritetit Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar konform kërkesave të parashtruara në FTD si dhe në përputhje me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18/12/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1000/2023, ndërsa me datë 19/12/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/1000 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE është Pajtuar pjesërisht lidhur me raportin e ekspertit shqyrtuesePaneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin Lidhur me pretendimet e OE: **" AS Tech " SH.P.K."** eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1000 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: "Aktiviteti i prokurimit me titull: "Servisimi dhe riparimi i klimave dhe chilerave për nevoja te PK-se" me nr. të prokurimit: "vetak-23-11095-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Posta e Kosovës Sh.A, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 18.10.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 25.10.2023, si dhe vendimi i AK-së mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit publikohet me datë 22.11.2023. OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga KA, me datë 12.12.2023 parashtron ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK ka shkel nenin 7, 59,60, 62 të LPP-së."

Konstatimi i parë (I): "Pretendimi i OE ankues kundër anulimit: Kërkesë e AK ne paramase ka qene vendosja e çmimeve për njësi, ashtu edhe i kemi vendosur dhe nuk është askund e bazuar ne ligj qe oferta jone te këtë tejkaluar vlerën. Sipas ligjit çmimet vendosen për njësi për ta vlerësuar ofertën me te lire ndërsa ne implementim te kontratës, ndërpritet ekzekutimi i saj ne momentin qe arrihet vlera e parashikuar ne këtë rast prej 9,500 euro. Oferta jone është dhënë e poentuar dhe askund nuk kemi dhënë çmim 28,000 euro siç pretendoni. AK ka vendosur disa sasi ne dosje te tenderit por qe ato nuk kane qene detyrim nga ana jone qe ti plotësojmë, ne e kemi plotësuar paramasen ashtu siç është dhënë nga AK. AK anulimin e aktivitetit nuk e mbështetet ne asnjërin rast te cekur me larte, prandaj kjo ky Vendim është i pabaze. Oferta jone është e përgjegjshme ne çdo aspekt te dokumentacionit, madje edhe çmimet janë shume te arsyeshme dhe AK askund nuk e mbështet vlerësimin e saj se kemi dhënë çmime te larta, AK ne asnjë rast nuk ka dhënë një sqarim se pse çmimet tona janë te larta, nuk ka bëra asnjë krahasim me çmimet e tregut aktualisht. Është e pavend krahasimi i çmimeve te ofertës tone ne këtë vit dhe ato te kontratave te kaluara kur dihet shume mire se çmimet janë rritur ne çdo aspekt sidomos 2 vitet e fundit. Nuk mund te merret si çmim referent një kontrate e para disa viteve dhe te krahasohet me çmimet aktuale te tregut. Ne jemi shume te vetëdijshëm për çmimet qe kemi dhënë, por AK e ka eliminuar ofertën tone pa kërkuar aspak sqarime. AK s'ka qene e interesuar për ta shpërblyer ofertën tone prandaj si ka ndjek hapat ligjor dhe shfrytëzimin e ligjit sis duhet. OE nuk duhet te eliminohet një oferte për një kriter qe nuk është i vendosur ne dosje, ndërsa AK

e eleminoni ofertën tone sepse sipas AK-se sasitë qe ka menduar për ti impelentuar janë te mëdha madje edhe e tejkalojnë vlerën te parashikuar. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit, shqyrtimit të shkresave të lëndës qartëson se, AK ka udhëhequr një aktivitet të prokurimit, lloji i kontratës shërbim, me procedurë kuotim i çmimit. I njëjti pas vlerësimit të ofertës me datë 22.11.2023 publikon vendimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, me arsyetimin citat: "Rezultati i aktivitetit te prokurimit: Posta e Kosovës SH.A pas rivlerësimit anulon komplet procedurën e këtij aktiviteti pasi qe i vetmi OE ishte i papërgjegjshëm" Tutje, ekspertja shqyrtuese sqaron se , AK pasi ka hap ofertat nuk mundet që të anuloj aktivitetin e prokurimit me arsyetimin e tillë, për faktin se AK ka vendosur peshën për njësit, si dhe çmimet ofrohen për njësi, si dhe kontrata lidhet për çmim njësi, dhe si e tillë, AK nëse konsideron se OE ankuesi ka vendosur çmime shumë lartë ose shumë të ulëta, për njësi, atëherë mund të kërkohet sqarime duke marrë parasysh çmimet e hulumtuara në treg konform LPP-së dhe rregullores për prokurim publik. Si përfundim, AK aktivitetin e prokurimit nuk mund ta anuloj me arsyetimin e nenit 62 të LPP-së pas hapjes së ofertave, dhe si e tillë rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim."

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas në mungesë të ofertave të përgjegjshme ka anuluar edhe aktivitetin e prokurimit. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi që i vetmi OE pjesëmarrës në këtë rast ankuesi ka rezultuar i papërgjegjshëm.

Vlenë të potencohet fakti se mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij nuk e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje, e që në rastin konkret nuk është i bazuar në prova dhe argumente.

Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese fakti se oferta e OE ankues rezulton mbi vlerën e parashikuar të kontratës, ngase tek Dosja e Tenderit tek Aneksi 1, AK ka paraparë edhe sasinë e përafërt për secilin artikull dhe ashtu sikurse AK edhe paneli shqyrtues mendon se publikimi i sasisë së përafërt të artikujëve me të cilët do të furnizohet AK, paraqet një informacion apo pasqyrim shumë të rëndësishëm për të gjitha palët, e posaçërisht edhe për një paraqitje më të dinjitetshme të ofertës. Kështu që, ky përshkrim i çmimeve ka qenë i publikuar për të gjitha palët dhe për çdo paqartësi

apo veprim nën supozim si të "paligjshëm", palët kanë pasur mundësi edhe me kërkuar informacione shtesë se si do të bëhet vlerësimi I ofertave apo edhe me atakuar me ankesë në fazën e para-tenderimit.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POSTA E KOSOVËS SH.A**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: